



# Bashkëpunimi i Fëmijëve me Avokatin e Popullit



# **Përmbajtja**

## **FALENDERIME**


### **1. HYRJE**

### **2. METODOLOGJIA**

### **3) BASHKËPUNIMI I INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT ME FËMIJËT DHE SHOQËRINË CIVILE**

#### **3.1) Bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me fëmijët;**

### **4) REKOMANDIME NGA FËMIJËT**



Ky dokument u hartua dhe botua në kuadër të projektit "Nga Fëmijët për Fëmijët", i financuar nga **Agjensia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar** dhe zbatuar nga **Save the Children** në bashkëpunim me **Zyrën e Avokatit të Popullit dhe Agjensinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve**.

@Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të fushës, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e organizatave, të përmendura më lart, si burim. Këndvështrimet e autorëve të këtij botimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e **Save the Children**.



## FLENDERIME

Një falenderim i veçantë shkon për fëmijët e grupit **Zëri 16+...**, të cilët morën pjesë në diskutimet e fokus grupeve në Durrës, Burrel, Elbasan dhe Dibër. Ata kanë ndarë me ne mendimet, eksperiencat, ndjesitë dhe sugjerimet e tyre duke i dhënë këtij dokumenti këndvështrimin e fëmijëve mbi bashkëpunimin e **Avokatit të Popullit** me fëmijët.

Pjesëmarrja dhe angazhimi kuptimplotë në të gjitha hapat e procesit të hartimit të këtij dokumenti, ka sjellë sugjerime konkrete mbi instrumentet dhe praktikat që duhen vënë në zbatim, në mënyrë që **Avokati i Popullit** të jetë më afër fëmijëve.

Një falenderim i veçantë i shkon Institucionit të **Avokatit të Popullit**, kryesisht specialistëve të Seksionit për **Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve**, të cilët trajtuan çështjet e udhëzuesit me qasje pozitive drejt një perspektive të përmirësimit të bashkëpunimit të Institucionit të **Avokatit të Popullit** me fëmijët.




## I.Hyrje

**Save the Children** në bashkëpunim me **Institucionin e Avokatit të Popullit**, ka hartuar një dokument udhëzues sesi fëmijët apo organizata të shoqërisë civile (OSHC) të bashkëveprojnë me këtë Institucion për të ngritur shqetësime që lidhen me shkelje të të drejtave të fëmijëve dhe të drejtave të njeriut. Udhëzimi ka për qëllim të mbështesë këta aktore për të kuptuar rolin e **Avokatit të Popullit** në përfaqësimin e interesave të publikut (në këtë rast të fëmijëve dhe OSHC) në adresimin e shkeljes së të drejtave nga strukturat e administratës lokale apo qendrore dhe nga ofruesit e shërbimeve. Udhëzuesi ofron informacion për mënyrat se si të qasen dhe të adresohen shqetësimet në këtë mekanizëm të rëndësishëm.

Për hartimin e udhëzuesit është përdorur një metodologji pjesëmarrëse me konsultime të gjera të grupeve të interesit, dhe prezantimi i tij është bërë në mënyrë metodike dhe terminologji profesionale. Kjo gjë që e bën të vështirë për t'u lexuar dhe kuptuar nga fëmijët, veçanërisht ata të një moshe më të vogël.

Në mënyrë që ky dokument burimor të jetë një mjet funksional, i dobishëm për të gjithë fëmijët në Shqipëri, përtej grupeve të fëmijëve me të cilët **Save the Children** punon, kemi synuar të sjellim një version të ri, të thjeshtëzuar dhe miqësor për fëmijët, për të siguruar adresimin e **Institucionit të Avokatit të Popullit** në ngritjen e shqetësimeve nga fëmijët që dëshirojnë të flasin për të drejtat e tyre që nuk respektohen apo çënohen.

**Zëri i fëmijëve 16+** dhe **Save the Children** shpreson se procesi i hartimit të këtij versioni miqësor të ketë ndikuar në fuqizimin e mëtejshëm të fëmijëve dhe në të njëjtën kohë të kontribuojë në përmirësimin e situatës së të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.




## 2. METODOLOGJIA

Ne jemi një grup fëmijësh që përfaqësojmë grupet Zëri 16+ nga Elbasani, Durrësi, Burreli dhe Peshkopia. Kemi folur më parë për një udhëzues mbi Bashkëpunimin mes Avokatit të Popullit dhe Fëmijëve që duan të ngrenë shqetësimet e tyre për moszbatimin e të drejtave të fëmijëve aty ku ne jetojmë, në familje, komunitet, në shkolla apo në cdo ambient tjetër.

Ne vumë re se dokumenti i Udhëzuesit ka një gjuhë të ngarkuar me terma që shpesh janë të vështira për t'u kuptuar dhe sidomos nga fëmijë më të vegjël ose nga grupe më të përjashtuara. Me shumë dëshirë morëm pjesë në këtë projekt për ta thjeshtëzuar e për ta bërë më të kuptueshëm dokumentin duke e sjellë në një gjuhë të thjeshtë për fëmijët, të kuptueshme dhe me shembuj praktik e ilustrime sepse mendojmë që e bëjnë udhëzuesin më të lehtë për t'u ndjekur dhe zbatuar.

Ne u ndamë në disa grupe sipas qyteteve ku jetojmë. Në secilin nga grupet morën pjesë rreth 6 - 7 fëmijë të cilët shprehën dëshirën të përfshiheshin direkt në konsultime, por duke mbajtur edhe komunikimin me shokët e tjerë të grupit ku kemi diskutuar për mënyrën sesi do i kuptonim pjesë të caktuara të udhëzuesit apo si ta kuptonim e si ta "përkthenim" në një gjuhë më feminare.

Si fillim, e ndamë udhëzuesin në pjesë për secilin grup. Pastaj, identifikua atë çfarë kuptonim mes asaj çfarë ishte më e vështirë për t'u kuptuar. Pjesët që dukeshin të vështira si dhe pyetjet që na dolën gjatë leximit i kemi diskutuar gjatë konsultimeve në grup së bashku me të rriturit që lehtësonin procesin. Përmes pyetjeve, diskutimit të përgjigjeve të mundshme apo nxitjes që ta shprehnim informacionin në mënyra sa më të thjeshta por edhe krijuese, ne arritëm të zbërthenim pak nga pak tekstin dhe të sillnim propozimet tona për rishkrimin e pjesëve.




Kishim shumë dëshirë që këtë proces ta realizonim duke u takuar me njëri tjetrin në workshope dhe të bisedonim direkt, të organizonim punë në grup, e më pas të prezantonim punët tona, por situata e izolimit për masat e vendosura për distancimin social për te parandaluar përhapjen e virusit COVID-19, nuk na e dha këtë mundësi. Takimet tona janë bërë online përmes platformës ZOOM brenda grupeve sipas qyteteve. Në fund, punët e secilit grup janë ndarë edhe me grupet e tjera për të marrë opinionin e bashkëmohatarëve për punën që ne kishim bërë. Opinionet dhe sugjerimet e tyre, kanë qenë me shumë vlerë.

Ne, mendojmë se arritëm më në fund të sjellim me fjalë të thjeshta të gjitha veprimet që një fëmijë apo grup fëmijësh do duhet të bëjë që të ngrejë shqetësimet për situatën e të drejtave të fëmijeve në zonat ku ne jetojmë.

Jemi shumë të kënaqur që një Institucion i pavarur si Avokati i Popullit, punon për të ndjekur shqetësimet që ne fëmijët shprehim për të patur një jetë dinjitoze ku të drejtat tona të kuptohen dhe të zbatohen nga të gjithë në mënyrë që të kemi të gjitha mundësitë për një zhvillim të mirë fizik, emocional dhe intelektual e për të siguruar një të ardhme më të mirë.

Ne, kemi sjellë në këtë dokument edhe disa sugjerime konkrete për zyrën e Avokatit të Popullit sesi ata mund të nxisin komunikimin me fëmijët dhe si të bëjnë që së bashku me ne, të njihen nga të gjithë fëmijët kudo në Shqipëri.

## Si të bashkëpunojmë me Institucionin e Avokatin të Popullit?



Unë jam fëmijë, kam të drejta  
Të rriturit duhet të mi  
garantojnë ato.

Kush e thotë këtë?



Këtë e thotë Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, të cilën vendi ynë dhe të gjithë shtetet e botës (me përjashtim 2) e njohin dhe kanë detyrim ta zbatojnë atë. Ka edhe dokumente evropiane që e thonë po ashtu.

E thotë Kushtetuta e Shqipërisë edhe Ligji për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve.

Të gjitha këto dokumente thonë që:

- Çdo fëmijë ka të drejtë që në çdo rast t'i mbrohet interesi i tij para çdo interesi tjetër (të të rriturve apo të institucioneve etj)
- Të gjithë fëmijët janë të barabartë. Ata duhet të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe pa asnjë diskriminim.
- Çdo fëmijë ka të drejtë të shprehë mendimet e tij lirisht dhe të rriturit duhet t'i dëgjojnë dhe respektojnë këto mendime.
- Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga abuzimi, shfrytëzimi dhe dhuna.
- Çdo fëmijë ka të drejtën të trajtohet me respekt dhe dhembshuri.
- Çdo fëmijë i sigurohet mbrojtje ligjore e përshtatshme dhe masa mbrojtëse.

E drejta për  
mësim



E drejta për  
lojë



E drejta për  
shëndet



E drejta për  
pjesmarrje



E drejta për  
mbrojtje







Po si nuk zbatohen të drejtat?

Po ja, nëse ti nuk shkon dot në shkollë, nëse ti je i detyruar të punosh, nëse ndaj teje ushtrohet dhunë në familje, apo në shkollë, apo nga çdo person edhe nga bashkëmoshatarët; nëse ti do të luash por nuk ke asnjë vend të lirë e të sigurt ta bësh këtë; nëse je i sëmurë dhe nuk merr shërbimin e duhur mjekësor; nëse do të shprehësh mendimin tënd por të rriturit nuk të dëgjojnë, nëse të gjykojnë sepse je ndryshe.....



Po e drejta ime për shërbim shëndetësor?

Unë a duhet të shkoj në shkollë?



Po ku të ankohe mi?



Në çdo shkollë funksionon shërbimi psiko - social dhe komisioni i etikës dhe sjelljes.

Prindërit janë të parët që duhet t'ju drejtohe mi.

Pranë çdo bashkie ka një njësi që ka detyrë të posaçme mbrojtjen e fëmijëve



Avokati i Popullit kujdeset që institucionet shtetërore të mos shkelin të drejtat e qytetarëve

Uauu çfarë titulli? Çfarë është ky Avokati i Popullit?



Policia garanton mjedis të sigurtë dhe të drejtat e shtetasve

Anisa



“Avokati i Popullit” është një zyrë në Tiranë ku personat që punojnë aty kanë për detyrë të mbrojnë të drejtat dhe interesat e çdo personi në Shqipëri nga veprimet e parregullta të administratës publike apo kush punon për të.

Avokati i Popullit nuk varet nga Qeveria ndaj dhe konsiderohet një institucion i pavarur dhe ka mundësinë të ngrejë shqetësime që lidhen me veprime të parregullta të qeverisë.

Avokati i Popullit udhëhiqet nga disa parime si: paanshmëria, pra nuk mban anën e asnjërës palë por udhëhiqet nga të drejtat, udhëhiqet nga parimet e konfidencialitetit, profesionalizmit dhe pavarësisë, ushtron veprimtarinë në mbrojtje të të drejtave dhe të lirive të njeriut, të parashikuara në dokumente të rëndësishëm ligjorë.

Gjithashtu, Avokati i Popullit punon me organizatat joqeveritare dhe kryen studime, publikon raporte mbi gjendjen e të drejtave të njeriut apo të fëmijëve në vendin tonë. Raportet prezantohen në Parlament ose në institucione Evropiane apo Ndërkombëtare dhe jepen rekomandime për përmirësimin e situatës së të drejtave të njeriut / fëmijëve në vendin tonë.

Punonjësit e Avokatit të Popullit kur marrin një ankesë apo shqetësim nga qytetarë / fëmijë apo dhe kur dëgjojnë ose njoftohen për një situatë ku mund të jenë cënuar të drejtat e fëmijëve bëjnë një vizitë dhe vlerësojnë situatën e shkeljes dhe hartojnë një raport.”



Për kë qeveri e ke fjalën?  
Ka q e madhe është qeveria?

Anisa



Bashkia, Shkolla, Spitali,  
Qendrat Komunitare,  
Policia, të gjitha këto bëjnë  
Institucione Publike Lokale





Po kush i drejtohet  
Avokatit të Popullit?


Anisa



Kushdo që ka një shqetësim për cënimin e të drejtave, vetë fëmijët ose një grup fëmijësh, prindërit, të rritur të tjerë që kujdesen për fëmijën, një avokat i fëmijës po ashtu.

Pra siç e thamë, Avokati i Popullit:

- Ka mundësi të trajtojë ankesat e individëve të caktuar për shkeljen e të drejtave të fëmijëve nga veprimet e gabuara ose edhe mosveprimet e institucioneve publike;
- Identifikon veprimet e parregullta të institucioneve shtetërore që ndikojnë direkt tek fëmijët si në rastin e shkollave, spitaleve, qendrave rezidenciale, burgjeve etj;
- Studion ligjet dhe bën propozime për përmirësime në lidhje me respektimin e të drejtave të fëmijëve
- Promovon ndërgjegjësimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve;
- Përgatit raporte mbi këto çështje pranë autoriteteve përkatëse si dhe paraqet rekomandime për vënien në zbatim të tyre
- Ligji detyron institucionet që kanë bërë shkelje të të drejtave të fëmijëve t'i përgjigjen Avokatit të Popullit dhe të marrin masa që këto shkelje të mos ndodhin më.



## Si realizohet bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me fëmijët:

Avokati i Popullit me të vërtetë i jep shumë rëndësi të drejtave dhe zërit të fëmijëve

Kur ka shumë takime dhe bisedime me fëmijët dhe kur këto takime janë të organizuara ashtu siç duhet në mënyrë që edhe pjesëmarrja e fëmijëve edhe mendimet e tyre të marrin vlerën e duhur.

Kur çdo fëmijë pavarësisht gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, nivelit ekonomik, social etj ka mundësinë të përfshihet në konsultimet apo diskutimet me Avokatin e Popullit.

Kur Avokati i Popullit vë interesat e fëmijëve mbi çdo interes tjetër.

Kur Avokati i Popullit i mban fëmijët të informuar mbi rezultatet e arritura si rrjedhojë e konsultimeve me fëmijët

Kur gjuha e përdorur është e thjeshtë dhe e kuptueshme nga të gjithë.

Kur ka respekt për mendimin dhe zërin e të gjitha palëve edhe të Avokatit të Popullit edhe të fëmijëve.

Kur arrihet që fëmijët të kenë besim tek veprimet e Avokatit të Popullit dhe kur ndihen të sigurtë të komunikojnë me ta.



Bashkëpunimi i mirë midis Avokatit të Popullit me fëmijët siguron që të drejtat e fëmijëve do të respektohen më shumë. Fëmijët ndihen mirë, ndihen të vlerësuar, forcojnë besimin tek vetja dhe mësojnë gjëra të reja kur marrin pjesë në grupe diskutimesh, kur ftohen të mendojnë dhe të shprehin për mënyren sesi trajtohen apo respektohen në ambientet ku jetojnë e mësojnë apo në shërbimet që marrin. Duke rritur të kuptuarin dhe vigjencën ndaj respektimit të të drejtave të fëmijëve nga kushdo, parandalohen edhe gabime apo cënime që mund ti shkaktohen fëmijëve.

## Si të Punojmë me Avokatin e Popullit

Grupe të ndryshme vullnetare fëmijësh të drejtuar nga vete ata siç është "Zëri 16+..." që është ngritur në disa qytete si Elbasani, Durrësi, Peshkopia dhe Burreli. Këto grupe kanë për qëllim të ndërgjegjësojnë fëmijët dhe të rriturit për njohjen dhe respektimin e të drejtave të tyre dhe të rrisin pjesëmarrjen e fëmijëve në çdo çështje që atyre u intereson apo i shqetëson. Fëmijë në një qendër rinore: Qendra apo organizata të ndryshme rinore.

Ligji thotë që Qeveria e Nxënësve është shumë e rëndësishme dhe do na ndihmonte që shkolla të jetë një ambient i sigurt, nxitës dhe miqësor dhe që bazohet tek respektimi i të drejtave të çdo fëmije.

### Në mënyrë skematike si do ta kontaktonim AP?

1. Shkruajmë një letër ku prezantohemi, themi arsyen pse po kontaktojmë me AP dhe bëjmë një përshkrim të shkurtër të shqetësimit që kemi. Letrën e dergojmë me postë në adresën postare: Avokati i Popullit, Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr.2, Zip Kod 1001, Tiranë.

Japim një model letre: Qyteti, .....Data ...

Drejtuar: Zyrës së Avokatit të Popullit, Seksionit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Unë jam, Eni Meta nxënëse në shkollën Mihal Grameno në Qytetin N.

Si rezultat i një sëmundjeje unë nuk mund të ecë vetë por lëviz me ndihmën e një karroce me rrota. Lasa ime është në kat të tretë dhe për mua është shumë e vështirë që të shkoj në klasë pa ndihmën e më të rriturve por edhe kjo është shumë e lodhshme.

Edhe me prindërit e kemi ngritur këtë pranë drejtorisë së shkollës por ata nuk kanë patur mundësinë të ndërtojnë rampa. Si unë mund të ketë edhe fëmijë të tjerë në këtë shkollë apo në shkolla të qytetit që kanë vështirësi nga mungesa e infrastruktures për aftësinë e kufizuar në shkollë. Kam nevojë për ndihmën tuaj në mënyrë që Bashkia të parashikojë investime për ndërtimin e rampave në shkollë.

Ju falenderoj dhe pres përgjigjen tuaj!

Me respekt

Eni Meta

Ne zarf shkruhet:

Dërgon Eni Meta, Shkolla Mihal Grameno, Qyteti N

Merr: Avokati i Popullit,

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve  
Bulevardi Zhan D'Ark, n... Tiranë



2. Përmes faqes së internetit të Avokatit të Popullit [www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al). Nëse do të hyjmë në këtë faqe ne do të gjejmë informacion se çfarë është Avokati i Popullit dhe çfarë bën ai. Në kategorinë ANKOHU ne shpjegojmë kush jemi dhe cili është shqetësimi që duam të ngremë. Duhet të japim informacionin e nevojshëm mbi shqetësimin që ne kemi dhe kërkojmë ndihmën e institucionit për zgjidhjen e problemit të paraqitur. Mesazhi dërgohet si më poshtë:

AVOKATI POPULLIT  
REPUBLIKA E SHqipëRIE

PERCAKTONI INFORMACIONIN E ANKESËS TUJAJ



Mungesa e ujit të njezdshëm në tualetet e shkollës

ZGJIDHINI NËSE KATEGORI

DERGO

## Çfarë duhet të bëjë Avokati i Popullit për të qenë sa më pranë fëmijëve?

- I drejtojmë një kërkesë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për të përfshirë në orët e lira informacion mbi rolin e institucionit të Avokatit të Popullit. Kështu fëmijët do të kenë më shumë informacion dhe do të rrisin bashkëpunimin e tyre me këtë institucion.
- Të vlefshme do të ishin takimet e shpeshta dhe të drejtëpërdrejta me fëmijët në shkolla ose qendra ditore, ku fëmijët do të informohen mbi rolin e institucionit të Avokatit të Popullit. E rëndësishme është edhe pjesëmarrja e prindërve. Të gjitha këto do të ndihmojnë në rritjen e besimit të fëmijët.
- Avokati i Popullit duhet të bëjë më shumë fushata ndërgjegjësimi dhe të publikojë një kalendar takimesh apo vizitash në rajone të ndryshme. Këtë e publikon në faqen e tij në internet dhe fëmijët mund ta lexojnë e të kuptojnë çfarë pritet të ndodhë.
- Promovimi nëpërmjet emisioneve televizive që kanë për qëllim informimin dhe funksionimin e rolit dhe institucioneve që përfshin Avokati i Popullit
- Organizimi i aktiviteteve miqësore për fëmijët, sipas ideve të tyre, në institucionin apo zyrën e Avokatit të Popullit. Të organizohen pritje apo vizita të fëmijëve nga e gjithë Shqipëria
- Organizimi i mbledhjeve në mjedise të përshtatshme, ku të sigurohet pjesëmarrja aktive e fëmijëve. Fëmijët të jenë aktivë në vendim marrje.
- Pyetësorë për të krahasuar përshtypjet e fëmijëve.
- Gjuhë miqësore, avokati është mik i fëmijëve.
- Duhet të mundësohen disa takime informuese për nxënësit e shkollave nga stafi i Avokatit të Popullit ose nga organizata të tjera, të cilat do t'i ndihmojnë fëmijët për të përgatitur vetë kërkesa apo ankesa mbi problemet që mund të kenë.
- Zyra e Avokatit të Popullit duhet të krijojë një faqe në internet për të gjitha ankesat apo kërkesat që kanë rregjistruar në lidhje me të drejtat e fëmijëve.
- Të bëhet i mundur krijimi i një faqeje online ku fëmijët të shprehin në një mënyrë sa më të thjeshtë gjërat që i shqetësojnë e gjithashtu ku të ketë materiale edukative për to. Avokati i Popullit komunikon thjeshtë e ofron ndihmën e parë online.
- Avokati i Popullit duhet të bëjë publike disa raste suksesi, në mënyrë që fëmijët të kenë besim kur të drejtohen tek ai.



**Save the Children**

Druga: Mihal Popi, Ndërtesa 7, ish Pallatet 1 Maji (Vila Lamj); PO Box 8185, Tiranë, Albania Phone: +355 4 2261840/+355 42261929/+355 4 2266227  
E-mail: [info.albania@savethechildren.org](mailto:info.albania@savethechildren.org) Web Page: [albania.savethechildren.net](http://albania.savethechildren.net)  [Savethechildrenal](https://www.facebook.com/Savethechildrenal)  [SaveChildrenAlb](https://twitter.com/SaveChildrenAlb)  [savethechildrenalbania](https://www.instagram.com/savethechildrenalbania)